

4.3 SKANIMI

Skanimi është procedurë, me të cilën mund të ngushtohet kërkimi në fushat e tjera për kërkim. Në këtë mënyrë mund të kërkohet edhe përmes fushave të paindeksuara dhe vlerave të treguesve ose të verifikohet prania e ndonjë nënfushe apo treguesi në regjistrimin bibliografik.

Procedura

1. Tek "Skanimi" shënoni shenjën e fushës dhe nënfushës ose treguesin, shenjën e barazimit dhe termin për kërkim. Më shumë pyetje për kërkim mund të lidhni me operatorët logjik. Mund të përdorni operatorin logjik DHE (duhet të vendosni shenjën "&"), operatorin logjik OSE (duhet të vendosni shenjën "&OR") dhe negacionin logjik (duhet të vendosni shenjën "&NOT").

Pyetjen për kërkim e shënoni në këtë formë:

<shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose treguesi>=<termi për kërkim>

ose

< shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim> & < shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim>...

ose

< shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim> &NOT < shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim>...

ose

< shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim> &OR < shenja e fushës>< shenja e nënfushës ose i treguesit>=<termi për kërkim>...

Mundësitë...

Kërkimin me përmbajtjen e nënfushave të caktuara dhe me vlerat e veçanta të treguesve mund ta përfshini edhe në pyetjen për kërkim tek kërkimi i specializuar.

Tek skanimi i nënfushave, termat për kërkim mund t'i shkurtoni në fillim, në mes ose në fund me shenjën "%" ose "*":

- shenja "%" zëvendëson një karakter (mund të ketë disa shenja "%" në një varg)
- shenja "*" zëvendëson vargun e dëshiruar të karaktereve



Shembull:

Tek "Pyetja për kërkim" shënoni $PY=2008/mon$ and $LA=alb$, ndërsa tek "Skanimi" shënoni $105f=g$ & $200tregl=0$

Në këtë mënyrë kërkohen regjistrimet për *monografitë* në *gjuhën shqipe*, të cilat janë botuar në vitin 2008 dhe në nënfushën $105f$ – *Kodi i letërsisë* përmbajnë kodin "g" – *poezia*, ndërsa në fushën 200 – *Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë* vlera e treguesit të parë është 0 – *Titulli nuk është i rëndësishëm*.



Shembull:

Tek "Pyetja për kërkim" shënoni $TD=2.30:2.32$ and $PY=207$, ndërsa tek "Skanimi" shënoni $101d=* &NOT$ $101d=eng$

Në këtë mënyrë kërkohen regjistrimet për *përmbledhjet e punimeve*, të cilat janë botuar në vitin 2007 dhe në fushën $001t$ – *Tipologjia e dokumenteve/veprave* kanë të shënuara kodet për tipologjinë "2.30", "2.31" ose "2.32" dhe kanë përmbledhje në cilëndo gjuhë tjetër ($101d$ – *Gjuha e përmbledhjes*), por jo në gjuhën angleze.



Shembull:

Tek "Skanimi" shënoni p.sh. $215a=%%f$.

Në këtë mënyrë përzgjidhni regjistrimet, të cilat në nënfushën $215a$ – *Përcaktimi specifik i materialit dhe formati* kanë hapsirë boshe pesë vendëshe dhe pas saj fjalën "f.". Këto janë regjistrimet, të cilat përmbajnë të dhënë për numrin e faqeve, që është më e madhe se 1000, përkatësisht në nënfushën $215a$ kanë të plotësuara të katër vendet (p.sh. [24] f.).

Në pyetjen për kërkim në fushën "Skanimi", nuk duhet të shënoni shenjat për aktivizimin dhe ç'aktivizimin e komandave LaTeX dhe shenjave NSB/NSE.

Mund të përdorni kllapat dhe me anë të tyre të rregulloni rendin e ekzekutimit të operacioneve të caktuara të kërkimit.

Rendi i ekzekutimit të operacioneve të kërkimit:

- kllapa
- "&NOT"
- "&"
- "&OR"



Shembull:

Tek "Skanimi" shënoni p.sh. $105f=a* &NOT$ ($205a=*ribo*$ &OR $100c=19*$)

Në këtë mënyrë gjeni regjistrimet për romanet e zhanrit tuaj të preferuar ($105f=a*$), midis të cilave nuk ndodhen ribotimet ($205a=*ponat*$), si dhe nuk janë botuar midis viteve 1900 dhe 1999 ($100c=19*$). Programi fillimisht kërkon për termat brenda kllapave.